

PKR.nr.275/18

NË EMËR TË POPULLIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues Naser Foniqi – gjyqtar profesionist, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të akuzuarit S.H., i akuzuar për shkak të veprave penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK dhe Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.255/2018, të datës 23.10.2018, pas shqyrtimit **fillestar**, të hapur, të mbajtur më datë 06.11.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i akuzuari S.H. dhe mbrojtësi i tij av. N.Sh., i caktuar sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit **fillestar**, të njëjtën ditë, me datë 06.11.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.H., i biri i R. dhe Z., e vajzërisë G., i lindur me datë ..., në fshatin L., Komuna Lipjan, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer Shkollën e Mesme të X., i martuar-baba i ... fëmijëve, i pa punë- realizon ndihmë sociale në shumë prej ... euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e paraburgimit nga data 28.09.2018 deri me datë 24.10.2018, ndërsa nën masën e arrestit shtëpiak nga data 24.10.2018 deri me datë 06.11.2018.**

Ë S H T Ë F A J T O R

1. S e p s e: pa autorizim ka kultivuar substancë narkotike, ashtu që me datë 28.09.2018, rreth orës 11:00, në shtëpinë e të akuzuarit e cila gjendet në fshatin L., Komuna L., gjatë kontrollit nga policia e Kosovës, është gjetur dhe sekuestruar sasi e narkotikut te llojit “marihuanë”, e shpërndarë në disa dhoma të katit 2 dhe 3 të shtëpisë, duke u terur me qëllim të shitjes, me peshë të përgjithshme prej 17.031 kg, të cilën e kishte kultivuar në oborrin e shtëpisë së tij dhe se në këtë shtëpi është gjetur një peshore digjitale dhe 360 euro, para të gatshme të cilat i akuzuari i ka përfituar me kryerjen e veprës penale si më lartë, -

- me këtë, ka kryer veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të KPRK dhe

2. S e p s e: në kohë vend dhe mënyrë si në pikën 1 të këtij dispozitivit të aktakuzës, i akuzuari ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuanë pa autorizim dhe me qëllim shitje, e cila është gjetur dhe sekuestruar në shtëpinë e të akuzuarit, ashtu siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të aktakuzës, në vend dhe sasi të përcaktuar,-

- me këtë, kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 1 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 41; 45; 46; 50; 51; 52; 62, par. 2.7; 73; 74; 75; 76; 278, par. 1 dhe 273, par. 1 dhe 5, të KPRK, si dhe nenit 365 të KPPK, të akuzuarit S.H., i shqipton:

- **Dënim burgimi, në kohëzgjatje prej shtat (7) muaj**, për veprën penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të KPRK, **si në pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit.**
- **Dënim burgimi, në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj dhe**
- **Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) € (euro)**, për veprën penale Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 1 të KPRK, **si në pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qoftë se i akuzuari gjatë afatit prej dy (2) vite, nuk do të kryej vepër të re penale.**

Me aplikimin e nenit **80, par.1, të KPRK** dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit S.H., gjykata i shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË ME KUSHT

- **Dënim burgimi në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë dhe**
- **Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) € (euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qoftë se i akuzuari gjatë afatit prej dy (2) vite, nuk do të kryej vepër të re penale.**
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e **paraburgimit** prej datës **28.09.2018 deri me datë 24.10.2018 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga data 24.10.2018 deri me datë 06.11.2018.**
- Nga i akuzuari si më lart, konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 17.031 kg, e cila është rezultat i kryerjes së veprës penale.
- Nga i akuzuari konfiskohet shuma e parave prej 360 euro, të sekuestruara nga policia, të cilat janë përfituar me vepër penale.
- I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së tij ekonomike.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Ferizaj, nr. 2018-DHTN-870, të datës 29.09.2018, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve me datë 29.08.2018, e pastaj ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.255/2018, të datës 23.10.2018, me të cilën ka akuzuar të pandehurin S.H., për shkak të veprave penale Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK dhe Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 06.11.2018, i akuzuari S.H., vullnetarisht dhe pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe nuk ka nevojë për sqarime shitesë, pastaj nga i njëjti gjykata ka kërkuar që të deklarohet lidhur me fajësinë, e në këtë fazë të procedurës penale i akuzuari është deklaruar fajtorë për veprat penale për të cilat është akuzuar, e të paraqitura si në dispozitivin 1 dhe 2, të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, kryetari i trupit gjykues, ka pyetur të akuzuarin nëse i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i akuzuari ka deklaruar se është i vetëdijshëm se gjykata mund t'i shqiptoi dënim për veprat penale për të cilat ka pranuar fajësinë, duke shtuar se i vjen keq dhe pendohet për këtë që ka bërë, si dhe është betuar se nuk do të merret më me këtë punë. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se ka qenë pjesëmarrës në luftën e Kroacisë dhe nga ajo kohë e ka përdorur substancën narkotike të marihuanës. Pastaj, i akuzuari ka theksuar se është në gjendje të rëndë ekonomike, e për të siguruar ekzistencën e familjes i është ndarë ndihma sociale në shumë prej 120 euro, me të cilën mban pesë anëtarët e familjes së tij. Në fund të fjalës së tij, i akuzuari ka thënë se përsëri kërkon falje, duke kërkuar nga gjykata që atij t'i shqiptoi një dënim më të butë.

Po ashtu, pas pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, gjykata ka marrë mendimin e prokurorit të shtetit i cili ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vlerësuar se ai mjaftueshëm është konsultuar me mbrojtësin e tij, ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se një pranim i tillë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj, prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që ta aprovoi këtë pranim të fajësisë nga i akuzuari dhe me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merret si rrethanë lehtësuese fakti se i pandehuri ka pranuar fajësinë si dhe gjendjen e rëndë ekonomike të tij.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, mbrojtësi i tij ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar edhe në procedurë paraprake, duke shtuar se i akuzuari është penduar thellë për këto veprime të tij të paligjshme, se ai është i gjendjes së dobët ekonomike, është baba i ... fëmijëve, mbajtës i familjes, asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, në këtë çështje penale nuk iu ka shmangur procedurës penale për të penguar mbarëvajtjen e saj, ka qenë korrekt dhe bashkëpunues me organet e ndjekjes dhe gjykatën. Në fund të fjalës së tij, mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që rastin e matjes së dënimit pasi të vlerësoi rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat janë të mjaftueshme, të akuzuarit t'i shqiptoi një dënim minimal të përcaktuar me KPRK, i cili do të mjaftonte të ketë efekt për qëllimin e dënimit. Po ashtu, mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që mjetet e konfiskuar prej 360 euro, të akuzuarit t'i kthehen ngase siç deklaroi i akuzuari ato mjete janë gjetur në një vend të posaçëm të mbajtura nga bashkëshortja e tij, të cilat i ka deklaruar me rastin e kontrollit të shtëpisë dhe se ato mjete janë të bashkëshortes së tij e të cilat ia kanë dërguar vëllezërit e saj që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit.

Pas fjalës së të akuzuarit, prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë për të akuzuarin pasi që kryetari i trupit gjykues është bindur se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se ky pranim është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij dhe se ky pranim është mbështetur në faktet që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit S.H., ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat është akuzuar

dhe për të cilat është shpallur fajtorë, përkatësisht nga: Raporti i testit fushor nr. 2018 DHTN 870, i datës 19.10.2018; vërtetimi mbi marrjen e sendeve i datës 28.09.2018; foto dokumentacioni në shkresat e lëndës dhe deklarimi i të akuzuarit, paraqesin prova të besueshme dhe mbi bazën e tyre vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprat penale të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Prandaj, gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit S.H., gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim:

- rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit; pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i njëjti edhe në procedurë paraprake e ka pranuar fajësinë; keqardhjen e shprehur nga i akuzuari pas kryerjes së veprës penale; betimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale dhe sjellja korrekte e të akuzuarit pas kryerjes së kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që në të dhënat e kësaj gjykate nuk rezulton që tani i akuzuari të jetë dënuar ndonjëherë me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër tjetër penale; ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, duke pasur parasysh se edhe narkotiku i gjetur te tani i akuzuari nuk ka qenë krejt i terur pasi kjo gjë shihet në foto dokumentacionin e propozuar si provë, ku vërehet sasia e narkotikut e njomë dhe një pjesë e saj duke u terur, gjë e cila ka rritur peshën e narkotikut. Ndërsa, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese në rastin konkret, duke vlerësuar faktin se tani i akuzuari nuk ka arritur që substancën narkotike ta shpërndaj apo shes te personat tjerë të cilët do të pësonin nga përdorimi i saj.

Andaj, gjykata të akuzuarit si më lart i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat i akuzuari edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit ndaj të akuzuarit S.H., pasi ka vlerësuar se edhe me një dënim më të butë se dënimi i paraparë me dispozitat e KPRK, mund të arrihet qëllimi i dënimit, e për këtë gjykata ka vlerësuar thëniet si më lart, si dhe është bazuar në dispozitat e neneve 75 dhe 76, par. 1, nënpar. 1.5, të KPRK.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, i njëjti u mor në bazë të nenit 453, par. 4, të KPPK, pasi që pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht, përkatësisht tre fëmijëve dhe bashkëshortes së tij, e po ashtu edhe për faktin se i njëjti është shfrytëzues i ndihmës sociale, sipas kartelës nr.7579, të lëshuar nga QPS-Lipjan, me datë 01.04.2017.

Vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 17.031 kg, si send i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 273, par. 5, të KPRK.

Ndërsa vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohet shuma e parave prej 360 euro, të sekuestruara nga policia, nën dyshimin se janë rezultat i kryerjes së veprës penale, u mor në bazë të nenit 69, par. 1, të KPRK.

Vendimi që koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 28.09.2018 deri me datë 24.10.2018 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga data 24.10.2018 deri me datë 06.11.2018, të akuzuarit t'i llogaritet në lartësinë e dënimit të shqiptuar, u mor në bazë të nenit 365, par. 1.5, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 07.11.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.275/18, datë 06.11.2018.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.

Nga një kopje e këtij aktgjykimi i dorëzohet: prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit.